



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:279365

Datë: 04.10.2024

Numri i dokumentit: 06254860

C.nr.2960/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtorin profesional Bionda Rexhepi, në çështjen kontestimore të paditëses M.F. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, me vlerë të kontestit 522.00 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 03.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.F. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore 12.04.2021 – 18.11.2022 për 261 ditë pune, duke llogaritur nga 2 euro në ditë, t’ia paguaj paditëses shumën prej 522.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 04.12.2023, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 04.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, në vlerë prej 522.00 euro.

Në padi ka theksuar se paditësja është i punësuar te e paditura, në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (në vijim: SHFMU) “Liria” në Pogradjë, në cilësinë e mësimitdhënëses dhe vazhdon të jetë në këtë pozitë të punës. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (në vijim: KKAK) të datës 22.01.2021 ka shtuar se paditëses i takon kompensimi për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore 12.04.2021 – 18.11.2022. Gjykatës i ka propozuar të aprovjë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrojë të paditurën t’ia kompensojë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në shumën e aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar pa i specifikuar.

E paditura me shkresën e datës 10.07.2024 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese që kanë të bëjnë me paditëses e sektorit të arsimit, të mbështetura në Kontratat Kolektive të Arsimit të vitit 2017 dhe 2021 dhe Vendimin e Qeverisë të vitit 2008, sa i përket kërkesave për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit, inflacionit, diferencës në pagë në bazë të kualifikimit, e pagës jubilarë. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të shpenzimeve të ushqimit, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Sa i përket kompensimit për orë shtesë mbi normën e punës, kjo kërkesë nuk gjen mbështetje ligjore, si dhe kontrata kolektive në fjalë zbatohet vetëm deri më datë 21.11.2022, andaj çdo kërkesë pas kësaj date duhet të refuzohet. Sa i përket kompensimit për punë gjatë vikendit (pandemi), bazuar në vendimin e MASHT-it, nr.01b/292 të datës 28.09.2021 paditëses kanë qenë të obliguar që ditët e humbura punuese gjatë kohëzgjatjes së pandemisë t'i zëvendësojnë, e në rastin konkret kemi të bëjmë me orë të zëvendësuara, e jo orë shtesë. Ka konsideruar se paditëses nuk kanë shtjerrë paraprakisht mjetet e brendshme të ankimimit, bazuar në nenin 78, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura dhe për periudhën kohore 12.04.2021 – 18.11.2022 ka gjithsej 261 ditë të pranisë në punë (fakt i vërtetuar edhe nga vërtetimi nr.251/2023 i dt.27.11.2023 i lëshuar nga SHFMU “Liria” në Pogradë).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del

bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 7 se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata e vërtetoi nga fakti se për shpenzimet e ushqimit nga 2 euro në ditë, për 261 ditë në total, arrijnë vlerën prej 522.00 euro.

Nga të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar të bazuar kërkesëpadinë paditëses për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se shpenzimet e ushqimit u kërkuan për periudhën sa ka qenë në fuqi KKAK e vitit 2021 dhe nuk janë përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 15.12.2023, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga data 12.04.2021. Edhe sa i përket pretendimit të të paditurës se paditësja nuk i ka shtjerrë mjetet e brendshme të ankimimit, gjykata vlerëson se në kategorinë e të drejtave nga marrëdhënia e punës sa i përket kompensimit monetar, mund të adresohet kërkesa drejtpërdrejtë në gjykatë, pa u ndjekur fare procedura e brendshme administrative.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të paditëses në procedurë, e njëjta nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës në mënyrë të specifikuar.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.2960/23, datë 03.10.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.